



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 38

Date : 30-07- 2024.

KONTRATË PROKURIMI NR 22

Numri i kontratës: 62500-24-6011-5-2-1/C818

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njënri anë; dhe

N.N.S.H."ARDI", CARRALLUKË, CARRALLUKË, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër; janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

RREGULLIMI DHE NDERIMI I KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA NE FSHATRAZAT BANJE, MIRUSHË, KËRVASARI, TEMEQINE, NGUCAT, SENIK, PAGARUSHË, KIJEVË, GURBARDHË, SHKARASHNIK, DRENOC,VERMICE, BELLANICE, GURISHTE, BURIM, MALISHEVË, BUBAVECË, PANORC, ASTRAZUP, DRAGOBIL, PLOQIC, BALINCE, BERISHË, JANÇISHTË,CARRALLUKË DHE LLADROC me numër identifikues: 62500-24-6011-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: RREGULLIMI DHE NDERIMI I KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA NE FSHATRAZAT BANJE, MIRUSHË, KËRVASARI, TEMEQINE, NGUCAT, SENIK, PAGARUSHË, KIJEVË, GURBARDHË, SHKARASHNIK, DRENOC,VERMICE, BELLANICE, GURISHTE, BURIM, MALISHEVË, BUBAVECË, PANORC, ASTRAZUP, DRAGOBIL, PLOQIC, BALINCE, BERISHË, JANÇISHTË,CARRALLUKË DHE LLADROC

No.	Lot
1	RREGULLIMI DHE NDERIMI I KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA NE FSHATRAZAT BANJE, MIRUSHË, KËRVASARI, TEMEQINE, NGUCAT, SENIK, PAGARUSHË, KIJEVË, GURBARDHË, SHKARASHNIK, DRENOC,VERMICE, BELLANICE, GURISHTE, BURIM, MALISHEVË, BUBAVECË, PANORC, ASTRAZUP, DRAGOBIL, PLOQIC, BALINCE, BERISHË, JANÇISHTË,CARRALLUKË DHE LLADROC

Neni 2

Cmimi

2.1 Cmimi total i punëve duhet të jetë: 408,920.00 €; [katerqindetëtetëmjëdhjetëqindënjëzetëeuro] Euro.

2.2 Cmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veganta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbehet nga dokumentet në vijim:

1 Ju lutemi referojuni këtu numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedural dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veganta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta Financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizites se vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpëjtojnë njëra tjetër; dhe në rastet e parqartësishë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cillin janë dhënë më sipër.



Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veganta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përcë nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjaltë "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Emri:	Besnik Krasniqi	Emri:	Mentor Hoti
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënskrimi:		Nënskrimi:	
Data:	30.07.2024	Data:	30.07.2024
Vula:		Vula:	



KUSHTET E PËRGJITSHME

Numri i kontratës: 62500-24-6011-5-2-1/C818

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të ciliat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, goshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rritim ndërtësash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veganta të kontratës (apo cildo njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për barjen e pajisjeve, dhe mjete të tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicë" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veganta të Kontratës.

Neni 2 Gjitha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha gëshjet që nuk janë të mbuluar në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfundim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkatëruar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e neni 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti Kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bërë.

3.4 Pranesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin aktet, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit kontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës së vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garantisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në garëdo momentin pas skadimit të periudhës së garantisë, t'i transferojë menjëherë të Autoritetit kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garantisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të bëjë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotëse dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim të mirë nga ndonjë defekt i saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të deyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas udhërave administrative që i jep autoriteti Kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimt për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin Kontraktues për këtë dukë i parqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet të respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu të respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që arrijnë do të bëjnë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkalën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i artë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajiset e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinga, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalamitarët e rastit, objektet përreth, trafikon etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyq dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit, Menaxheri i Projektit do të aprovtoj çdo zëvendësim të personelit kyq dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas tëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziget e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfishirë, pa kufizim, Punët, Implantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziget e Kontraktuesit dhe pronës së atërit.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuase të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Implantave dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Implantave, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjedhjen e atarit të orimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë aratin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë gminin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, aratin kohor që kërkohet për dorëzimin dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohet, dhe aratin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkim modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuar, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të Projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Parafija e programit të tillë, duke përfishirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuar, si dhe çdo modifikim të përfishirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfishirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndritimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërryja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të vegantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, pa marrë parasysh se ato kryhen në masë të vegantë që ai synon të ndërmarret para se kryej ato. Riparimet e Autoritetin kontraktues për çfarëdo masë të vegantë që ai synon të ndërmarret para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkakuar nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatum

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatumet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatumet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në gminin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë gminin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngrihtë të tatumëve dhe detyrimëve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejohet ndryshimi e gminit të kontraktuar për shkak të ngrihtës së tatumëve dhe/ose ngrihtës së detyrimëve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesit.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të përfundimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të përfundoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e përfundimit të punëve

18.1 Kontraktuesi mund të kërkohet zgjatje të përfundimit të punëve nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjë arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar të plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuar si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkese për zgjatje të përfundimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Neni 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejohet me shkrim Kontraktuesit të kërkojë zgjatje të përfundimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective ose retrospective, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të përfundimit.

Neni 19 Dëmet e llikuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguajë dëmet e llikuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonesë Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të llikuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbris dëmet e llikuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të llikuiduara nuk do të detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të neni 19.1 ai mundet, pasi ta

- (a) konfiskoje garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërprerë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALI DHE MËSHTRITË

Neni 20 Regjistrimi i punës

20.1 Një regjistër i punës do të përvetësohet ndryshe nga KV, mbahen në vend-punë nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të pakten informacionin e mëposhtëm:

kushet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orë e punës, numrin dhe llojin e punësorëve të punësuar në vend-punë, materialin e furnizuar, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuar si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësisme të të gjitha elementeve sasiorë dhe cilësorë të punës së bërë dhe furnizimit e dorëzuar dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punë dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënime të bëra në regjistrin e punës, si punë në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dëshon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënime të paraqitura në regjistrin e punës. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrë të duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialin e përpunuar me specifikime, vizatime, sondazhet, modellet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit Kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rasti. Komponentët dhe materialin e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga Autoriteti Kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialin apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialin dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të caktuar në KV, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuase të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rënësive të kontratës.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialin e dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit Kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmirësimin e detyrës.

22.4 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialin, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimt të gfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialët dhe pjesët e kërkuar, kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishje ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialët i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultate të testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj fjetit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do të dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kosoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo tëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo tëshimeve, gofshin ato në skica apo në specifikim teknik, atëherë do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërtimeve subjektive të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilit substancialisht ndikojnë në gëminin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimitin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Paguesa

24.1 Paguesat do të bëhen në Euro.

24.2 Paguesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të citat nuk është dhënë normë apo gëmin nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluar nga norma dhe gëminet tjera në Kontratë.

24.4 Paguesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmblahet për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur gëminin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmblajë aktivitetet me gëmin për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

praneshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe vlerë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posqëtrisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturve ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përmirëshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përcaktuar të punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbatja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KV, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtur do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogaritë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do të dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të gënimëve të vlerësuar të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do të kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet të i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduara përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogaritë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogaritë që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përkrahimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduara përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkakëve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogaritë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përfundim të kontratës, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogaritë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogaritë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogaritë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të citat i takojnë Autoriteti Kontraktues sipas kontratës, bilancit, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, sipas mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi, deklaratën e llogaritë përfundimtare që paraget shumën përfundimtare dhe Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfundimtare i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogaritë përfundimtare, si një njoftje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaget për kompensim

30.1 Shkage për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërimit data e posedimit e specifikuar në R.VK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shityje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatime, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në arafin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRQJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Vërtifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për vërtifikimin me kusht që Kontraktuesi të jetë informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së vërtifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer vërtifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën vërtifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhrë të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti Kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin Kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyt e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti Kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i gmon ton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materiallet që nuk kërkohen më për përdorim përkatëz me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit sig kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmtimeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialave të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) qdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërtrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryjë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në rastet urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrijë menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do të lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Përmes parasysh lëshimit e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parcalizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

**SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA
Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyjë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga sigurta

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa genë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdheron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërprejë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbyshjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë kufizohen rrethanat emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbyshjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbyshjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga Kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpre punën menjëherë, do të siguroj vend punim dhe ta liroj vend punim brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" sig përdoret këtu mendohet në rregullimet industriale, rregullimet civile, luftëtar, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë eji e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashtikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbyshjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbyshje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkëlqes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektes do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materiale e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjaltë dhe minus projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materiale e porositura duke i aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkëlqes materiale bazë të kontratës nga Autoritetit Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materiale e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materiale dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërrthimi i lurtës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vlerëtoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punim dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vlerëtimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të përpilojë shkresën për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Përuadha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrim në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykatara apo arbitrim.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-24-6011-5-2-1/C818

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitatë këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentim/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Pershkrimi i nenit	Neni. Nr.	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha gëshjet që nuk mbulojnë nga dispozitatë e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykatë përkatëse në Prishtinë.	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha SHQIPË .
Gjuha e përdorur	2.2	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës.	
Signoria e Ekzekutimit		Kontraktuesi (OE) i bartë të gjitha rreziket që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punimeve si lëndime personale, vdekje, humbje të pasurisë për shkak të kufizimeve të gjatë pasurisë si dhe rreziket tjera që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punimeve se punimeve që kanë të bëjnë me këtë kontratë.	
Programi	8.1	Kontraktuesi (OE) do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët që do të kryhen e që do të fillojnë brenda pesë (5) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës.	
Vendosja e tabelës	8.2	OE është i obliguar ta vendos një tabelë në vendin e punimeve në të cilën duhet të shkruhet emri i AK si investitor dhe të kryesit të punimeve OE, si dhe të shenjë në tabel emrin e projektit.	
Menaxheri i Projektit	9.1	Menaxheri i projektit është përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuëse të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti kontraktues.	
Menaxheri i Punëve	10.1	Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjasin punimet duke filluar nga dita e parë e fillimit të punimeve e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe sasinë e materialëve dhe cilësinë e tyre.	
Fillimi i punëve	10.1	AK e ruan të drejtën që të ia ndërprej kontratën me OE për mos realizim të kontratës në cilësi dhe afatë dhe në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës.	
Fillimi i punëve	10.1	Punimet do të fillojnë brenda pesë (5) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës por mund të fillojnë edhe më herët nëse OE është i përgatitur. Kjo vërtetohet në raportin e menaxherit të projektit.	
Obligimet e OE		OE është i obliguar që rregullimin dhe ndërtimin e kanalizimeve të cekur në specifikacionin e ofertës ta e kryej në përputhje me të plotë me specifikacionin e ofertës.	
Përfundimi i punëve	10.2	Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë jo më e gjatë se data 30.10.2025 duke filluar afatit të rrjedhë që nga dita e nënshkrimit të kontratës.	

<p>Përmirësimi i defekteve</p>	<p>13.1</p>	<p>Nëse kontraktuesi me përfaqësimin e tij nuk arrin të dorëzojë/realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, përdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa parargjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, të marrë dëmnet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të përfunduara/realizuara deri në një maksimum prej [10%] të vlerës totale të kontratës dhe NDALESEN E SHTE I OBLIGUAR TA E BEJ MENAXHERI I PROJEKTTI gjatë përgatitjes së raportit për punim të punimeve.</p>
<p>Përmirësimi i defekteve</p>	<p>13.1</p>	<p>Në rast të defekteve menaxheri i projektit i ofron një afatë optimal kontraktuesit për përmirësim të defekteve por afati për përmirësim të defekteve nuk duhet të jetë më i gjatë se shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës së AK nga ana e OE .</p> <p>Përmirësimi i defekteve (nëse ndodhin defekte) duhet të bëhet prej ditës së fillimit të punimeve e deri në pranimin përfundimtar të punimeve.</p>
<p>Shkqetë kompensim për</p>	<p>17.1</p>	<p>Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës .</p>
<p>Dëmet e likuiduara</p>	<p>19.1</p>	<p>Sipas nenit 19 të KPK.</p>
<p>Parapagim</p>	<p>20.1</p>	<p>Shuma e Parapagimit është: Nuk do të ketë parapagim (Avans)</p>
<p>Pagesat</p>		<p>Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimit të punimeve nga zyrtari përkatës për punim të punimeve (menaxheri i kontratës) rreth rregullimit dhe nderimit të</p> <p>Kanalizimeve si dhe raportin e pranimit të komisionit të caktuar nga ZKA i AK dhe faturën nga OE të ia paguaj shumën sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate</p> <p>Pagesat OE do të i behen në bazë të raportit të menaxherit të kontratës ndërsa pagesa finale do të bëhet në bazë të raportit të menaxherit të kontratës dhe raportit të një komisioni të caktuar nga ZKA për punim të punimeve.</p>
<p>Pranimi teknik i punimeve</p>		<p>Pranimi teknik i punimeve do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK.</p>
<p>Garancioni i punimeve</p>		<p>Punët e kryera nga OE kanë garancion dymbdhjetë (12) muaj nga dita e pranimit teknik të punimeve, nëse në punët e kryera paraqiten defekte gjatë periudhës së garancionit OE është i obliguar të bëjë përmirësimin e tyre, nëse nuk kryhet përmirësimi i defekteve nga ana e OE atëherë lenda do të dergohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e qeshtës.</p>
<p>Pranimi përfundimtar i Punimeve</p>		<p>Pranimi përfundimtar i punimeve do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK mbas kalimit të periudhës prej 12 muaj nga dita e pranimit teknik të punimeve.</p>
<p>Pagesa pas shërbujes së kontratës</p>	<p>27.1</p>	<p>Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfundohen koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve.</p>

Zgjidhja mësores e mosmarrëveshjeve	31.2
Palët do të mundohen që çdo marrëveshje të zgjedhin më marrëveshje mësores.	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe së nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1

RRREGULLIMI DHE NDERTIMI I KANALIZIMEVE TE UJRAVE TE ZEZA NE FSHATRRAT: BANJE, MIRUSHË, KËRVASARI, TEMBQINË, NGUCAT, SENIK, PAGARUSHË, KIJEVË, GURBARDHË, SHKARASHNIK, DRENOC, VERMICE, BEJLANICË, GURISHTË, BURIM, MALISHEVË, BUBAVECË, PANORC, ASTRAZUP, DRAGOBI, PLOQC, BALINCË, BERISHË, JANÇISHTË, CARALLUKË DHE LIADROC

PARAMASA DHE PARALLOGORIA

1. PUNËT GJEODOZIKE

Poz	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Gjimi	Totali (€)
1,1	Matjet gjeodozike shënimi i trasës vendosja e pikave gjeodozike (kuotave) në terren dhe inqizimi i rrjetit, si dhe dorëzimi i dokumentacionit për kartës, dhe bartja e makinerve në terren për aktivitet të punimeve. Vrejtje: Obligohet kontraktori i punimeve që pasë përfundimit të punimeve të bëjë inqizimin gjeodozik të ekzekutimit të punimeve me koordinata x,y,z dhe ta dorëzojë në cd dhe kopje fizike - të merren koordinatat në fund të pusetes (në formatin shapelle 1 kopje fizike dhe 1 elektronike)	m'	13.000,0	1,00 €	13.000,00 €
1,2	Pastrimi i terrenit largimi i drunjeve shkurtrave dhe pengesave tjera në trase, dhe ngarkimi i tyre në deponi në largësi deri në 3,0km.	m'	13.000,0	2,00 €	26.000,00 €
1,3	Largimi i ujrave nëntokore gjatë paraqitjes në kanal si dhe rregullimi i instalimeve nëntokore (kablove elektrike, gypa të ujtjellesit dhe natyra të tjera të ngjashme).	m'	13.000,0	1,00 €	13.000,00 €
totali : 1 :					52.000,00 €

Poz	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Gjimi	Totali (€)
2,1	Hapja e kanalit në thellësi prej 1,20 m' deri në thellësinë 2,0m' dhe gjerësi të nevojshme për punë duke përcjellë të gjitha pikat gjeodezike sipas projektit . Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me cilindër bretkoc pjesa ka do të vendost gypi i kanalizimit. Vrejtje: sigurtimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryeri, si dhe në llogari të përfshihet edhe mbyllja e kanalit si dhe largimi i dheut të tepërt. Kategoria e tokës III-VII.	m ³	14.560,0	5,00 €	72.800,00 €
2,2	Planifikimi i fundit të kanalit pas gërmimit sipas pjerësis së projektuar. Llogaria në m ² .	m ²	9.100,0	1,00 €	9.100,00 €
2. PUNËT E DHEUT					

2,3	Shtuarja e rërës për gat gjithë gjatësin se kanalit në trashësi minimale prej d = 10.0 cm , po ashtu mbulimi i gypit me rere, duke i japur edhe ramje sipas projektit, dhe pikave gjedodezike. Po ashtu dhe nën bazamentin e pusetave të nivelizohet me rërë ku trashësia e rërës të jetë minimum 10.0cm . Vrejtje grimca maksimale e rërës duhet të jetë 4-8mm.	m ³	4.160,0	15,00 €	62.400,00 €
2,4	Furnizimi dhe vendosja e gypave të brinjëzuar Tub:H.D.E Ø 400 PE SN8 për gatë gjithë gjatësin se kanalit montimi të behët në mënyrë profesionale me te gjitha elementet përçelles . Vrejtje të sjellen atëstet e gypave.	m'	300,0	20,00 €	6.000,00 €
2,5	Furnizimi dhe vendosja e gypave të brinjëzuar Tub:H.D.E Ø 315 PE SN8 për gatë gjithë gjatësin se kanalit montimi të behët në mënyrë profesionale me te gjitha elementet përçelles . Vrejtje të sjellen atëstet e gypave.	m'	7.700,0	14,50 €	111.650,00 €
2,6	Furnizimi dhe vendosja e gypave të brinjëzuar Tub:H.D.E Ø 250 PE SN8 për gatë gjithë gjatësin se kanalit montimi të behët në mënyrë profesionale me te gjitha elementet përçelles . Vrejtje të sjellen atëstet e gypave.	m'	3.000,0	11,00 €	33.000,00 €
2,7	Furnizimi dhe vendosja e gypave të brinjëzuar Tub:H.D.E Ø 200 PE SN8 për gatë gjithë gjatësin se kanalit montimi të behët në mënyrë profesionale me te gjitha elementet përçelles . Vrejtje të sjellen atëstet e gypave.	m'	2.000,0	6,00 €	12.000,00 €
2,8	Kalimi nën rrugën e asfaltuar me makin laserike per vendosjen e gypit të qelikut Ø 457 në të cilen do vendoset gypi H.D.E.Ø 400 PE SN8	m'	18,0	200,00 €	3.600,00 €
2,9	Kalimi nën rrugën e asfaltuar me makin laserike per vendosjen e gypit të qelikut Ø 355 në të cilen do vendoset gypi H.D.E.Ø 315 PE SN8	m'	48,0	150,00 €	7.200,00 €
2,10	Kalimi nën rrugën e asfaltuar me makin laserike per vendosjen e gypit të qelikut Ø 325 në të cilen do vendoset gypi H.D.E.Ø 250 PE SN8	m'	36,0	120,00 €	4.320,00 €
2,11	Kalimi nën rrugën e asfaltuar me makin laserike per vendosjen e gypit të qelikut Ø 219 në të cilen do vendoset gypi H.D.E.Ø 200 PE SN8	m'	30,0	100,00 €	3.000,00 €
2,12	Furnizimi me material dhe vendosja e shiritit paralel per gatë gjithë gjatësin se kanalit në distanc perj 30.0cm' mbi shtresën e sipërme të gypit.	m'	13.000,0	0,10 €	1.300,00 €
		totali : 2 :			326.370,00 €
3.PUNËT E MONTIMIT TË TUBAVE					
Poz	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali (€)
3,1	Furnizimi me material dhe montimi i tubave të betonit Ø800 mm' nga betoni i parafabrikuar C-30/37nga elementet e parapregaditura.Montimi i tyre të behët në mënyrë profesionale sipas të gjitha rregullave teknike të montimit në mënyrë të saktë dhe të drejtë . Vrejtje të sjellen atëstet e gypave të betonit.	cope	325,0	30,00 €	9.750,00 €

Poz	Pershkrimi i aktiviteve	Njesia	Sasia	Gjimi	Totali (€)
4,1	Testimi i rrjetit	m'	13,000,0	0,30 €	3,900,00 €
4,2	Kchim i terenit në gjendjen e mëparshme,	m'	13,000,0	0,30 €	3,900,00 €
totali : 4 :					7,800,00 €
REKAPITULLIM					
I	1.PUNËT GJEODOZIKE				52,000,00 €
II	2.PUNËT E DHËRËT				326,370,00 €
III	3.PUNËT E MONTIMIT TE TUBAVE				22,750,00 €
IV	4.PUNËT TJERA				7,800,00 €
V	5.TOTALI				408,920,00 €
3,3	Furnizimi me material dhe montimi i konuseve të betonit Ø 800/600 mm' nga betoni i parafabrikuara.C-30/37, me elemente të parapregaditura, montimi i tyre të bëhet në mënyrë profesionale sipas të gjitha rregullave teknike të montimit në mënyrë të sakt dhe të drejtë..Vrejtje të sjellen atëstet e gypave të betonit.	copë	325,0	20,00 €	6,500,00 €
3,4	Furnizimi me material dhe vendosja e kapakve nga betoni i armuar,me trashësi d = 12,0cm	copë	325,0	20,00 €	6,500,00 €
totali : 3 :					22,750,00 €
4.PUNËT TJERA					
Poz	Pershkrimi i aktiviteve	Njesia	Sasia	Gjimi	Totali (€)